

MENDIM NË PAKICE

Mbi votimin “KUNDËR” ndaj qëndrimit të shumicës, në lidhje me Vendimin nr. 253, datë 12.11.2019, referuar çështjes që i përket “Skualifikimit të kandidatit z. {...}, i diplomuar për magjistrat në shkollën e magjistraturës dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar”.

Në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 12.11.2019 (ditë e martë), është përfshirë për shqyrtim në këtë mbledhje edhe projektvendimit “Për verifikim e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. {...}”

Për sa më sipër, nisur nga fakti që kam mbajtur qëndrim të kundërt me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bazuar në nenin 66 pikën 9, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit Të Drejtësisë”

Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor...

...9. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinioni i tij t’i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit...po parashtroj sa më poshtë argumentet e mia, në lidhje me këtë çështje:

Së pari: Bazuar në nenin 35, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **Emërimi i kandidatit magjistrat të diplomuar, pika 1, shkronja c)** “ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.”

dhe nenit 32, të ligjit të mësipërm, **Verifikimi i pasurisë dhe figurës, pika 2** “...Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pas shqyrtimit të materialeve të çështjes së kandidatit për gjyqtar z. {...}, paraqiti në mbledhje plenare para Këshillit të Lartë Gjyqësor, propozimin për “skualifikim të kandidatit z. {...}, pasi nuk arrin të kalojë me sukses pas verifikimit të bërë, kriterin e pasurisë”.

Ky konkluzion u arrit nga Komisioni dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më pas me vendim, pasi analizoi raportin “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, përpiluar nga ILDKPKI, me kërkesë të Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Institucioni i ILDKPKI, pas depozitimit të deklaratës së pasurisë dhe dokumenteve të nevojshme nga vetë kandidati, për të bërë të mundur kontrollin e pasurisë, asetëve dhe interesave të deklaruara nga kandidati {...}, konkludon:

“...Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’ i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” konstatohet se për kandidatin {...}:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të justifikuar burim financiar të pasurive;
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

- Mosparaqitje të dokumentacionit ligjor për të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve si tregtar ambulant, të ardhura të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me vlerë 9.000.000 lekë, sip. 77.97 m2, rruga “Grigor Heba”, Tiranë. Gjithashtu me të ardhurat nga aktiviteti i tyre privat si shitës ambulant fruta-perime, kanë mundur përveç pagesës së apartamentit të mësipërm edhe ndërtimin e shtëpisë së tyre të banimit me 2 kate në Tiranë, pagesën e shkollimit të kandidatit në universitet jopublik, si dhe kanë përballuar shpenzimet për konsum familjar ndër vite.

Duke analizuar pikën a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, të konkluzioneve të arritura në raportin e përgatitur nga ILDKPKI, nuk rezulton që ky konkluzion të përkohet me përmbajtjen e raportit të ILDKPKI, pasi vetë raporti nuk e qartëson cilat janë pasaktësitë e konstatuara në deklarim ose gjatë procesit të kontrollit.

Nga përmbajtja e raportit të parë përcjellë me shkresën nr. 3788/18 prot., datë 1.10.2019 dhe raportit të dytë përcjellë me shkresën nr. 3332/13 prot., datë 9.10.2019, nuk rezulton në përmbajtjen e tyre që të jetë evidentuar pasaktësi në plotësimin e deklaratës së pasurisë nga kandidati. Vetë ILDKPKI ka konstatuar se të dhënat e deklaruara në rubrikat përkatëse përkohet me provat e dorëzuara nga kandidati bashkëlidhur deklaratës.

Gjithashtu gjatë procesit të verifikimit, siç konstatohet në këto dy raporte, deklarinimet dhe qëndrimi i mbajtur nga kandidati për pasuritë dhe të ardhurat e deklaruara ka qenë i njëjtë me deklarinimin fillestar dhe dokumentacionin e dorëzuar prej tij. Për këto arsye konkluzioni i arritur nga ILDKPKI se, deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, është një konkluzion që nuk përkon me përmbajtjen e raporteve të hartuar nga ky Institucion dhe me konstatimet e bëra prej tij.

Ky konkluzion i përcjellë nga ILDKPKI lidhur me deklarinimin e kandidatit, ndërkohë që ka rezultuar se **nuk përkon me asnjë nga gjetjet që përmban pjesa arsyetuese e raporteve, e cila ka rënduar pozitën e kandidatit në mënyrë të pa bazuar dhe nuk duhej të merrej në konsideratë nga Këshilli në vendimmarrjen e tij.**

Për sa i takon konkluzionit të dytë se: *“b) nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të justifikuar burim financiar të pasurive”*, është e nevojshme të analizojmë faktin që kandidati z. {...} në relacionin shpjegues depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të përmbushur barrën e provës lidhur me vërtetimin e ligjshmërisë dhe për të justifikuar pasurinë në emër të tij, konkretisht të apartamentin me vlerë 9.000.000 lekë, sip. 77.97 m², rruga “Grigor Heba”, Tiranë, pronë e cila është regjistruar në emër të tij nga prindërit, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore.

Kandidati provon se ka kërkuar pranë subjektit privat, Raiffaisen Bank sh.a. informacion lidhur me llogarinë e nënës së tij znj. {...}, të krijuar para viti 1997 dhe për gjendjen e llogarisë dhe interesat e përfituara para tërheqjes së tyre.

Nga kjo kërkesë e kandidatit ka rezultuar nga provat e paraqitura se, Raiffeisen Bank sh.a ka refuzuar të japë informacion në lidhje me një pjesë të shumës së të ardhurave, të përdorura për blerjen e apartamenti në emër të tij nga prindërit, pasi kjo Banke pretendon se *“nuk disponon të dhëna të mëparshme të trashëguara nga ish Banka e Kursimeve”*.

Ndërkohë rezulton se Raiffaisen Bank sh.a ka trashëguar gjithë të drejtat dhe detyrimet, për pasojë edhe bazën e të dhënave të ish Bankës së Kursimeve, transferim i kryer në vitin 2004. Në kushtet kur subjektit privat Raiffaisen Bank sh.a. i ka kaluar pronësia e plotë e aksioneve të ish Bankës së Kursimeve, ka pasur detyrimin ligjor për t'i vënë në dispozicion kandidatit të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Gjithashtu rezulton se, kandidati më pas i është drejtuar Bankës së Shqipërisë me kërkesë për informacion, e cila gjithashtu vërteton se *“nuk ka trashëguar detyrimet e asnjë institucioni”*, dhe për këtë arsye nuk mund të japë informacion mbi llogarinë bankare të depozituar, e më pas tërhequr nga nëna e kandidati përpara vitit 2004. Ndodhur përpara këtij fakti, me të drejtë kandidati pretendon që ka pamundësi objektive të provojë këtë fakt.

Por nga ana tjetër bazuar në ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 *“Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”* i ndryshuar, **nenin 26**

Detyrimi për të dhënat

*“Për kryerjen e kontrollit dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës, Inspektorati i Lartë ka të drejtë të shfrytëzojë të dhënat e nevojshme në të gjithë aparatit shtetëror e publik dhe në personat juridikë publikë e privatë. Nëse të dhënat e përcaktuara në këtë nen ruhen dhe administrohen në formë elektronike ose nëse përpunimi dhe përditësimi i tyre kryhet në format elektronik ose ndërfaqje elektronike, **institucioni publik ose personi juridik publik apo privat ka detyrimin të japë informacionin e kërkuar nëpërmjet sistemit elektronik të Inspektoratit***

të Lartë, i cili do të mundësojë ndërlidhjen dhe shkëmbimin e të dhënave të regjistruara në regjistrat apo bazën e të dhënave elektronike të këtyre autoriteteve.....”

vetë institucioni përgjegjës, ILDKPKI, duhet të ushtronte detyrimin e përcaktuar në ligj, në kuadër të kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ, me qëllim arritjen më pas të konkluzioneve të sakta, të plota dhe të bazuar plotësisht në ligj dhe në lidhje me rrethanat e faktit për çdo rast konkret.

Për të realizuar këtë qëllim ILDKPKI duhet të kishte bërë kërkimet e nevojshme pranë subjektit privat dhe të merrte informacionin e nevojshëm, veprim të cilin nuk e ka kryer, pasi në raportin e institucionit përpiluar për kandidatin z. {...} nuk citohet të jetë kryer një veprim i tillë.

Për sa më sipër vlerësojmë se raporti i pasqyruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të parën dhe të dytën herë nga institucioni i ILDKPKI-së, **është i pa plotë dhe i përciptë, pasi realisht institucioni nuk ka kryer një hetim të thelluar të çështjes.**

Së dyti: Ndodhur përpara këtij fakti, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe Këshilli, nuk duhet të ishte mjaftuar për të gjykuar dhe vendosur mbi kriterin e pasurisë së z. {...} duke u bazuar vetëm në raportin e dhënë nga ILDKPKI, por duke ju referuar **nenit 32**, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

“.....2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. **Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.**

3. Cdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.....”

Këshilli i Lartë Gjyqësor kishte mundësinë ligjore për të thelluar hetimin, duke i kërkuar vetë subjektit privat, në këtë rast Raiffaisen Bank, **“Kërkesë për informacion”** dhe pritur një përgjigje zyrtare, duke mos ndëshkuar kështu kandidatin, për një pamundësi objektive për të gjetur dokumentacionin e nevojshëm.

Lidhur me burimin e të ardhurave, kandidati ka qenë konsistent (në deklaratë, shpjegimet e dhëna prej tij drejtuar Këshillit pas njohjes me rezultatet e raportit të dytë të përcjellë nga ILDKPKI) duke deklaruar të njëjtin burim për krijimin e të ardhurave të prindërve të tij.

Kandidati ka deklaruar se burimi i të ardhurave është fitimi i realizuar nga vetëpunësimi i tyre si shitës ambulantë. Kjo veprimtari është regjistruar pranë QKB-së më datë 7.09.2012, në emër

të babait të tij {...}, por kandidati parashtron se veprimtaria është ushtruar para këtij momenti dhe ka shërbyer si burim për të ardhurat e familjes.

Subjekti ka bërë të gjitha përpjekjet dhe ka ezauruar detyrimin për të kërkuar dhe përcjellë dokumentacionin dhe të dhënat që disponohen nga Institucionet respektive. Ajo për çfarë penalizohet në këtë rast kandidati z. {...}, është pamundësia për të vërtetuar të ardhurat e prindërve të tij, veprimtari *si tregtar ambulant, në disa tregje të lira* përpara viteve 2004, kur realisht bëhet fjalë për dokumentacione të hershme dhe në konceptin e ligjit për taksat vendore të kohës, i cili e ka rregulluar konceptin juridik të tregtarit ambulant nëpërmjet ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar,

Neni 11

Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël

*“...4. Niveli tregues i taksës, për çdo kategori biznesi në varësi të qarkullimit vjetor, të ndarë sipas intervaleve prej 1 milion lekësh, duke filluar nga vlera minimale prej 2 milion lekësh, jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, detyrimi fiskal tregues është i fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi. Për bizneset me qarkullim më të madh se 2 milion lekë deri në 8 milionë lekë në vit, detyrimi fiskal tregues është i barabartë me shumën e detyrimit për bizneset me qarkullim deri në 2 milion lekë, shtuar me vlerën që del nga shumëzimi i madhësisë prej 1,5 për qind me vlerën në lekë të mesit të çdo intervali prej 1 milion lekësh, sipas të cilit ndahet intervali i qarkullimit 2-8 milionë lekë, **përiashtuar rastet e ambulantëve dhe të transportit, të cilat kanë një mënyrë tjetër taksimi, që tregohet në të njëjtin aneks, që i bashkëlidhet këtij ligji.**”*

Referuar përkufizimit sipas ligjit të sipërpërmendur “Ambulantë” konsiderohen vetëm bizneset pa vend fiks që kanë qarkullim jo më të madh se 2 milionë lekë në vit. Nëse vlerësohet se qarkullimi është më i madh ato klasifikohen në një nga kategoritë e tjera të biznesit dhe taksohen sipas asaj kategorie.

Duke qenë se prindërit e kandidatit kanë ushtruar veprimtarinë e tregtarit ambulant, nuk kanë qenë të detyruar të regjistrohen në organet e administratës tatimore, por kanë pasur detyrimin të deklarojnë pranë organeve të qeverisjes vendore, vetëm për pagimin e tarifës vendore (për biznesin dhe zënien e hapësirës publike).

Për të provuar veprimtarinë e babait të tij si tregtar ambulant para regjistrimit në organet tatimore në vitin 2012, kandidati ka kërkuar të dhëna pranë Bashkisë Laç e cila me shkresën nr. 3707 prot datë 02.08.2019 informon se për periudhën 1993-2005 nuk ka ruajtur dokumente arkivore.

Duke iu drejtuar Bashkisë si institucion i qeverisjes vendore, e cila ka qenë përgjegjëse për vjeljen e tarifës vendore për tregtarët ambulantë kandidati ka kryer veprimet e mundshme për të provuar faktet për të cilat i është ngarkua barra e provës. Fakti që Bashkia nuk ka ruajtur dokumentacionin e nevojshëm për vitet 1997-2005, nuk duhet të penalizojë subjektin dhe duhet të analizohet në raport me parimin e proporcionalitetit, duke vlerësuar sjelljen e subjektit dhe mundësitë e tij reale për të provuar fakte të caktuara.

Vetëm nëse subjekti do të kishte mundësi për t'i provuar faktet dhe nuk do të ndërmerre veprimet e nevojshme mund të ngarkohej me përgjegjësi për mosveprim, për të provuar burimin e krijimit të pasurisë së tij. Në kushtet kur subjekti ka kryer gjitha veprimet e nevojshme dhe nuk ka mundur të sjellë prova të plota për faktet objekt i barrës së provës, jo për faj të tij, por për shkak se institucionet nuk kanë ruajtur të dhënat përkatëse, nuk mund të penalizohet për një fakt apo rrethanë që nuk është përgjegjësi të kandidatit, për sa kohë të ardhurat nuk rezultojnë apo nuk ngrihen dyshime që të kenë burim të paligjshëm.

Gjithashtu fakti që prindërit e kandidatit kanë ushtruar aktivitetin e tregtarit ambulant, përpara vitit 2012, vit në të cilin kanë regjistruar aktivitetin në QKB, rezultojnë edhe nga një provë tjetër e administruar nga ILDKPKI gjatë hetimit administrativ. Konkretisht autorizimi administrativ nr. 276, i vitit 2002 i Inspektoratit Shtetëror të Punës Lezhë, lëshuar subjektit fizik {...} “transport mallrash”, ky akt tregon që aktiviteti tregtar i prindërve të kandidatit nuk ka filluar për herë të parë në vitin 2012, por është ushtruar në vazhdimësi edhe përpara këtij viti dhe mund të justifikohen ligjërisht të ardhurat e tyre familjare.

Në këto kushte, duke vlerësuar veprimet dhe mosveprimet e kandidatit, raportin e tij me atë pjesë të ardhurave të prindërve që rezultojnë të pa mbështetura në dokumentacion ligjor, koha në të cilën janë realizuar këto të ardhura, kuadrin ligjor që ka rregulluar veprimtarinë e tregtarit ambulant në kohën përkatëse, mos pasjen e të dhënave nga Institucioni përgjegjës (Bashkia) për taksat dhe tarifatat vendore të aplikuara mbi subjektet “tregtar ambulant” në vitet 1997-2005, si dhe konsekuencën e kandidatit në deklarin e burimeve të krijimit të pasurisë e cila ka qenë e njëjtë përgjatë gjithë procesit të zhvilluar ndaj tij, vlerësoj se kandidati ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta.

Për sa argumentuar më sipër, kandidati z. {...} nuk duhet të penalizohet për pamundësinë e dokumentimit për një pjesë të vogël të ardhurave të prindërve të tij, që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, pamundësi kjo që nuk vjen për faj të kandidatit.

Për këtë arsye mendojmë se Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të mbante një qëndrim të ndryshëm, nga ai i “Skualifikimit të kandidatit z. {...}, i diplomuar për magjistrat në shkollën e magistraturës dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar”.

Për sa më sipër, shprehim qëndrimin dhe argumentet tona dhe votuam “KUNDËR” propozimit për refuzimin e emërimit të z. {...} si gjyqtar.

**Zëvendëskryetar
MAKSIM QOKU**

**Anëtar
MEDI BICI**